


# 10 Tipe për prindër: Si ti motivoni fëmijët tuaj të mësojnë.



## 1. Krijoni një mjedis të mirë mësimi

Një vend i rregullt pune dhe një mjedis i qetë mësimi ndihmojnë fëmijët tuaj të qëndrojnë te përqëndruar.



## 2. Gjeni stimulimin e duhur

Formuloni qëllimet që fëmijës suaj t'i pelqejnë më shumë, saqë vetë të motivohet për mësim, p.sh. “Kush është mirë ne biologji, ka mundësi të bëhet një veteriner (mjek i kafshëve)”.

## 3. Proveni që tema e përditshme Corona, të mos bëhet temë kryesore në familje.

#### **4. Një herë, dy herë merrni frymë thellë**

Pushimet e mjaftueshme në mes të përmbajtjes së mësimit janë shumë të rëndësishme, një stërvitje e vogël dhe të pini ujë do t'ju ndihmojë. Në këtë mënyrë materialet mësimore kuptohen më mirë .



#### **5. Nuk ka shikim të televizorit gjatë pauzës mësimore**

Në pauzat gjatë të mësuarit si dhe në shkollë nuk duhet të shikoni televizor. "Eshtë për fëmijët motivacion i sigurt nëse së bashku uleni që të hani ushqim të lehtë, të shkëmbeni ide me ta dhe diskutoni se çfarë mund të bëni së bashku pasdite dhe si do të deshironin ta kalonin kohën e lirë",

#### **6. Jep sugjerime (këshilla) për të mësuar**

Prindërit nuk duhet të bëhen mësues zëvendësues, sepse kjo mund të tendosë (pengojë) marrëdhëniet. Sidoqoftë, ju mund t'ju jepni fëmijëve tuaj shumë sugjerime (këshilla).

Tashmë kur zgjoheni dhe kur shkoni në gjumë duhet të ruhen zakonet e mëparshme të jetës së përditshme shkollore – visheni, hani mëngjes, mësoni, bëni pushim.

Bëni një ndryshim të rolit dhe lereni, që fëmija juaj t'ju tregojë çfarë ka mësuar tash. Kjo rrit vetëbesimin. I ndihmon në anën tjetër të jenë me metoda kreative dhe motivimi për mësim rritet.

## 7. Përdorimi i internetit

- Ka faqe të ndryshme të internetit për fëmijë, që nxënësit dhe të tjerët mund t'i përdorin për hulumtime.
- Aplikacionet e mira gjithashtu ndihmojnë për të kuptuar dhe zbatuar përmbajtjen e të mësuarit në menyrë argëtuese (me lojra)  
: [www.integrationsfonds.at/app](http://www.integrationsfonds.at/app)
- Die Online-Lernplattformen: [www.sprachportal.at](http://www.sprachportal.at)



## 8. Përmbajtja shkollore duhet të integrohet në përditshmëri

Llogaritje gjatë pjekjes, mësim gjatë lojës dhe punëdores (basteln), dëgjoni muzikë dhe shikoni filma...Ju mund të mësoni në çdo kohë, në çdo vend.



## **9. „Ju mund ta bëni këtë!“ Forconi shpinën**

Tregojini fëmijës suaj pikat e tij të forta.

Shmangni, nëse është e mundur, shpërblimet me ëmbëlsira, nganjëherë zëvendësojini ato me televizor apo kompjuter. Ky motivim funksionon vetëm në një afat të shkurtër.

## **10. Mësoni me një plan**

Një plan mësimor ose lista e të mësuarit të ndihmon për stimulimin e mësimit.

Në një plan mësimor është përcaktuar për çdo ditë, çka duhet mësuar dhe si të shpërbleni veten për të. Rezultatet e të mësuarit shënohen në një listë mësimi për të bërë kontrollin pasi ato të jenë kryer.



Aufgabe	Tageszeit	Häkchen
	morgens	
	morgens	
	morgens	
	morgens	
<b>Na? Hast du alle Häkchen gesammelt? = dein erster Stern</b>		
	mittags	
	mittags	
	mittags	
	mittags	
	mittags	
<b>Wieder alle Häkchen? = dein zweiter Stern</b>		
	abends	
	abends	
	abends	
	abends	
<b>Schon wieder alles voll? = dein dritter Stern</b>		